



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 375/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bashkim Ademaj në cilësinë e Zyrtarit të lartë Komunal Zgjedhor (ZLKZ) dega në Istog, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Istog, për shkak të mbajtjes së tubimit politik pa paralajmërim, në seancën e panelit të mbajtur me 01.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Bashkim Ademaj në cilësinë e Zyrtarit të Lartë Komunal Zgjedhor (ZLKZ), dega në Istog, kështu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Istog, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 550 (pesëqindpesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 29.10.2013, PZAP-i, nga Bashkim Ademaj (ZLKZ) dega në Istog, në të cilën pretendohet se me datë 24.10.2013, ka pranuar në zyrën e Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ), njoftimin nga rreshteri policor Sylë Mehmetukaj, zyrtar policor për zgjedhje, stacioni policor në komunën e Istogut se me datën 22.10.2013 në fshatin Orroberd në restaurantin “Dea Oil”, është mbajtur një tubim politik i pa lajmëruar i subjektit politik LDK, i cili ka filluar rreth orës 21:30 deri me 22:15, ku prezent ishin rreth 40 persona. Sipas parashtresës të ankesës programin politik e ka shpalosur Haki Rugova, Agim Ademaj dhe Hazbi Bajraj, ndërsa tubimi ka përfunduar i qetë dhe pa asnjë incident. Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës raportin policor.

Në raportin policor nga rreshteri policor Sylë Mehmetukaj, po ashtu theksohet se është mbajtur tubim politik parazgjedhor i pa lajmëruar, i subjektit politik LDK, në fshatin Orroberdë në restaurantin “Dea Oil”, me datën 22.10.2013, rreth orës 21:30 deri në ora 22:15, ku prezent ishin 40 persona, ndërsa programin politik e ka shpalosur Haki Rugova kandidat për kryetar të komunës dhe kandidatët për asamble komunale Agim Ademaj dhe Hazbi Bajraj. Ky tubim ka përfunduar i qetë dhe pa incident, theksohet në raportin policor.

PZAP-i, e informoi subjektin politik LDK, në kuptim të Nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 30.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më

datë 31.10.2013. Sipas afatit të caktuar, PZAP- i mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik LDK, në të cilën theksohet se sa i përket ankesës së Bashkim Ademaj – ZLKZ në Istog e vlerësojmë se është e pabazë nga fakti sepse tubimi në restaurantin “Dea Oil”, ka qenë moment i pushimit dhe i pirjes së kafes pas tubimit parazgjedhor në fshatin Orroberd.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të bazuara pasi që neni 4.2 i Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, lidhur me Fushatën Zgjedhore dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike, theksohet se subjekti i certifikuar politik që dëshiron të organizojë dhe të mbajë një tubim publik gjatë periudhës së fushatës zgjedhore duhet që të Zyrta i Lartë Komunal i Zgjedhjeve i asaj Komune (ZLKZ), të dorëzojë formularin e plotësuar të Njoftimit për Mbajtjen e Tubimit Politik (FNJMTP) me së voni shtatëdhjetë e dy (72) orë përpara. Prandaj PZAP-i, duke u mbështetur në dispozitën ligjore konstatoi se subjekti politik AAK, nuk e ka njoftuar organin kompetent komunal, në këtë rast ZLKZ, për mbajtjen e këtij tubimi, andaj mbi këtë bazë dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 dhe 120.1.c të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendim

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 375/2013 më datën 01.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*